



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ .2021

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: **“Bajrami N” sh.p.k.** me adresë: Rruga Elbasan - Xibrakë, NJ.A. Labinot - Fushë, km 13, Elbasan.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Asfaltobeton” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit **2,583,300** (dymilion e pesëqind e tëtëdhjetë e tremijë e treqind) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan.

Shumatorja e çmimeve për njësi është **21,104** (njëzet e njëmijë e njëqind e katër) **lekë pa t.v.sh.**

Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-86734-02-11-2021

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Murati” sh.p.k me Nipt: J 66702413 V

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është **15,500** (pesëmbëdhjetëmijë e pesëqind) **lekë** (pa tvsh).

2. “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është **15,800** (pesëmbëdhjetëmijë e tetëqind) **lekë** (pa tvsh).

3. “Ervin Luzi” p.f. me Nipt: K 71707007 Q

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është **19,000** (nëntëmbëdhjetëmijë) **lekë** (pa tvsh).

4. “Sark” sh.p.k me Nipt: K 52531415 H

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **2,180,708** (dymilion e njëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) **lekë** (pa tvsh).

5. “BI-Servis” sh.p.k me Nipt: K 41614010 T

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **2.114.612,90** (dymilion e njëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë presje nëntëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- 1. “Murati” sh.p.k me Nipt: J 66702413 V**
- 2. “Ervin Luzi” p.f. me Nipt: K 71707007 Q**
- 3. “Sark” sh.p.k me Nipt: K 52531415 H**
- 4. “BI-Servis” sh.p.k me Nipt: K 41614010 T**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertuesi “Murati” sh.p.k, skualifikohet për arsye se: Ky operator ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues vetëm një dokument narrativ dhe asnjë dokumentacion tjetër provues si kontrata te ngjashme, kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ka patur detyrimin ligjor (në referim të nenit 56, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar) që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e kontrates pranë autoritetit kontraktor. Nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e shërbimit, pasi provueshmeria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e shërbimit por për realizimin e tij sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurrues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin

dhe faktet e shtjelluara më lart, Autoriteti Kontraktor gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Murati” shpk, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar), duke mos krijuar në këtë mënyrë bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

“Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

2. Ofertuesi “Ervin Luzi” p.f., skualifikohet për arsye se: Ky operator kishte mangësi në dokumentacionin e paraqitur e konkretisht:

a. Në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet : **Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme** në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës se fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit...

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur fatura tatimore shitjeje, objekti i të cilave, nuk është i ngjashëm me objektin e prokurimit.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

b. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet : Operatori ekonomik duhet të **disponojë një kamion me tonazh 3.5 deri 7.5 ton** për transport të mallrave objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- *Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;*

ose

- *Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit*, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vetë ose të treta për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur dokumentacion jo të plotë për automjetin e marrë me qira pasi mungon siguracioni i mjetit, çertifikata e kontrollit teknik, vertetimi që ka paguar taksat vjetore si dhe leja e transportit për këtë automjet .

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

c. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet : Operatori Ekonomik duhet te disponoje ne pronesi, ose me qera ose te kete kontrate noteriale furnizimi per "Linje prodhimi Elemente Betoni".

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur nje kontrate furnizimi me furnizuesin, p.f. Gazmir Kasa, ku objekti i kontrates eshte furnizimi me “Linje prodhimi Elemente Betoni dhe per Impjant Inertesh” por per nje tender me numer reference te ndryshem nga objekti i prokurimit duke e bere e pavlefshme kete kontrate noteriale furnizimi.

Gjithashtu OE ka paraqitur nje kontrate furnizimi me subjektin "Varaku" sh.p.k., per binder dhe asfaltobeton, por qe nuk eshte kontrate furnizimi noteriale, sic kerkohet ne kriteret e vecanta te kualifikimit.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

3. Ofertuesi “Sark” sh.p.k, skualifikohet për arsye se: operatori ekonomik ka ofertuar me çmim total, dhe jo me shumatoren të çmimeve për njësi në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shtojcën 10 -Sasia dhe Grafiku i lëvrimit- ku kërkohet që: Bazuar në Udhëzimin e APP-së nr.6 datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7.3, ndryshuar me Udhëzimin e APP-së nr.15 datë 26.11.2018, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi.

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

4. Ofertuesi “BI-Servis” sh.p.k., skualifikohet për arsye se: operatori ekonomik ka ofertuar me çmim total, dhe jo me shumatoren të çmimeve për njësi në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shtojcën 10 -Sasia dhe Grafiku i lëvrimit- ku kërkohet që: Bazuar në Udhëzimin e APP-së nr.6 datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7.3, ndryshuar me Udhëzimin e APP-së nr.15 datë 26.11.2018, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi.

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është **15,800** (pesëmbëdhjetëmijë e tetëqind) **lekë** (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 12.03.2021

Ankesa: nuk ka pasur

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Irland Sina**